

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



**PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË<sup>1</sup>, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA**

**PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

**Kuvendi Komunal Novobërdë** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe

**NTP Deli me seli ne Novobërdë** (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

**Transporti i nxënësve për shkollën fillore Asdreni në Llabjan ” me numër identifikues: NB 654 2019 022 221 LOT 2**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

**Transporti i nxënësve për shkollën fillore Asdreni në Llabjan LOT 2 në relacionin Baqovisht, Koznic, Sallkovit, Abazaj, Talaj, Degellaj, Zeqiraj, Parallov deri te shkolla Asdreni Llabjan dhe anasjelltas.**

[shëno përshkrimin e përgjithshëm të shërbimeve]

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjë prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në

<sup>1</sup> Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ofertuesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

**1.5 Kontrata hynë në fuqi Pas nënshkrimit të kontratës dhe përfundon në datën pas 15 muajve pas nënshkrimit të kontratës**

## **Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 15muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes për gjdo muaj nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **relacionin Baqovisht ,Koznic,Sallkovit , Abazaj ,Talaj,Degellaj,Zeqiraj,Parallov deri te shkolla Asdreni Llabjan dhe anasjellas .**

## **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

| Pjesa nr. | Përshkrimi i shkurtër                                                                                              | Sasia e perafert e km vjetore | Çmimi per Km me TVSH | Totali me TVSH |
|-----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|----------------------|----------------|
| 1         | <b>Lot 2.</b> Transporti i nxënësve në relacionin Baqovisht ,Koznic,Sallkovit dhe Abazaj –Llabjan dhe anasjellas . | 10406                         | 2.16€                | 22.476.96€     |

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është  $[+/-30\%]$ .

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisë do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

## **Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kontrata Publike Kornizë;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- Urdhër blerja;

(g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

### Për Autoritetin Kontraktues

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | Fatos Ahmeti                                                                        |
| Pozita:     | Menaxher i Prokurimit                                                               |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 11.12.2019                                                                          |
| Vula:       |  |

### Për Ofruesin e Shërbimeve

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | SKENDER NCHIQ                                                                       |
| Pozita:     | DREKTOR                                                                             |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 11.12.2019                                                                          |
| Vula:       |  |

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

**PJESA III E KONTRATËS****KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|-------------------------------------|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                  | Nr. Nenit |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha        | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|                                     | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Obligimet e Autoritetit Kontraktues | 12.3      | Menaxheri i Projektit do të emrohet me vendim nga ana e Kryetarit të Komunës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|                                     |           | Menaxheri i emëruar nga ana e kryetarit duhet të ketë parasysh që asnjë porosi për transport të nxënësve nuk duhet ta lejohet pa pasur zotimin e mjeteve në gjëdo fillim muaji                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Siguria e ekzekutimit               | 8.1       | OE, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Komuna e Novobërdës një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës.<br>Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është:<br>10% (dhjetë përqind) i vlerës së kontratës për një kohëzgjatje prej 16 muajve.<br>Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Periodha e ekzekutimit të detyrave  | 12        | Kurdo që Autoriteti Kontraktues pale e kësaj kontrate dëshirojnë që bëjë transportin e nxënësve sipas kësaj kontrate, duhet që gjdo fillim të muajit të dërgojnë një "Flete Porosi" tek OE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Cilësia e furnizimeve               | 16.2      | <b>Kontraktuesi obligohet që transportin e nxënësve ta kryej me (Kombi, Kombi Bus, varësisht prej nevojave të transportit, apo numrit të nxënësve e që numri i nxënësve për këtë LOT është Relacioni Baqovishtë- 7-Zeqiraj 19 nxëns ,Relacioni Koznic- 20 nxëns –Talaj 8 , Relacioni Sallkaj-Llabjan 17 nxëns ,Abazaj- 19 nxëns degellaj 6 nxansa ,Relacioni Paralloj prej Gurthysit Tali 11 nxënsa ,qafë e llapjanit(lagj%ja e re) 19 nxënsa deri të shkolla Asdreni dhe Anasjelltas .</b><br><br>Automjetet me të cilën transportohen nxënësit duhet të jetë i shenjëzuar me emrin e firmës përfituesit të kontratës dhe të ketë shenjë treguese që bënë transportin e Nxënësve, automjeti të ngjitet nga shoferi me provoj dhe profesional me kategori B apo D varësisht prej Automjetit Transportues , automjeti të jetë gjdoher në gjendje të |

|                        |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                        |      | <p><b>mirë higjienike</b></p> <p><b>Kontraktuesi obligohet qe të kontaktoj me drejtori e sh.f. Asdreni për rregullimin e orarit për transportit e nxënësve por duke pasur parasysh qe fëmijët mos te dërgohen ne shkollë apo te miren nga shkolla më shumë se 25 minutë ma herët se fillimi i mësimi apo mbarimi i mësimi duke pas parasysh qe te angazhoj dy ose më shum kombi busa varsisht prej nevojës për transport .</b></p> <p><b>Kontraktuesi obligohet që te rrespektoj pikat e qe cakton menagjerin e kontrates në te gjitha relacionet e cekuar më lartë për marjen dhe kthimin e nxënësve .</b></p>                                               |
| Inspektimi dhe testimi | 17.2 | Drejtori i shkollës rezervojnë te drejtën qe te inspektojnë gjatë gjithë kohë mënyrën e transportin te nxënësve dhe për gjdo parregullsi apo mos respektin ,shkelje te kontratës ti raportoj menjëherë Menaxherit te kontratës i cili do te emërohet nga AK .                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Pagesat                | 18   | <p>Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet ne baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual. Nuk ka pagesa paraprake.</p> <p>Kërkesat për pagese do të bëhet në baza mujore ( ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit te faturave.</p> <p>Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro.</p> <p>Pagesat bëhen gjdo fund muaj pasi qe drejtori i shkollës te raportoj me shkrim tek menaxheri i kontrates se kompania ka kryer transportin ne mënyrë korrekte duke ju përmbajtur kushteve te kontratës si dhe te jetë vërtetuar fatura nga ana e menaxherit te kontratës .</p> <p>Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro</p> |
| Vonesa ne pagesa       | 18.5 | Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që të ndërpresë furnizimet e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues përkatës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Dorëzimi               | 19.3 | <p>Anulimi i porosisë :</p> <p>Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për për transport me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para kohës së liferimit të porositur.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Verifikimi i operimeve | 20   | Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet kontraktues                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Pranimi i përkohshëm   | 21   | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Obligimet e            | 22.1 | OE garanton që transporti i nxënësve te bëhet ë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe te                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |

|                                                   |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| garancionit                                       |      | <p>kushtet e veçanta të kontratës .</p> <p>OE garanton që transporti nuk do të ketë asnjë defekt cilësor dhe se në rast të konstatimit të këtyre defekteve nga menaxheri i kontratës apo drejtoria e shkollës , OE do të bëjë përpjekje maksimale për eliminimin e atyre defekteve .</p> <p>Në rast të defekteve apo mosfunksionimit normal i transportit të nxënësve , të shkaktuara nga cilësia e dobët e transportit , OE zotohet të bëjë kompensimin total të dëmeve të shkaktuara nga cilësia jo adekuate e transportit .</p>                                                                                                                             |
|                                                   | 22.5 | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Shërbimet pas shitjes                             | 23.1 | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Pranimi përfundimtar                              | 25   | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues | 26   | Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë shkëputjen e kontratës nëse drejtoria e arsimit nuk mund të sigurojë mjete financiare për transport të nxënësve brenda periudhës së kërkuar prej 15 muajsh apo nëse konstatohet se OE nuk po i përmbahet kushteve të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Ndërprerja e Kontratës nga Furnizuesi             | 27   | Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet autoritet kontraktues                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 29.2 | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në Kosovë është përgjegjës për pajtim të tillë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 30.1 | <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës.</p> <p>ose</p> <p>a) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> |

| # | Pershkrimi i shërbimeve                                                                                                                                             | Njesia | Sasia e përafërt vjetore | Cmimi pa TVSH | TVSH | Cmimi me TVSH | Totali me TVSH |
|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|--------------------------|---------------|------|---------------|----------------|
| 2 | Lot 2. Transporti i nxënësve në relacionin Baqovisht , Koznic, Sallkovit dhe Abazaj, Talaj, Degellaj, Zëqiraj, Parallov – Shkolla Asdreni Llabjan dhe anasjelltas . | km     | 10406,00                 | 1,83          | 0,33 | 2,16          | 22476,96       |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) |                   |
|-----------------------------------------|-------------------|
| EMRI I OE:                              | SKENDER NUHIU B.I |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQSUESIT TE OE:  | SKENDER NUHIU     |
| NENSHKRIMI:                             |                   |
| DATA:                                   | 2019-09-30        |
| VULA:                                   |                   |